



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 21.07.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **21.07.2023**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **BS2 SH.P.K**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i QKMF ne Drenas"** me Nr. të Prok: **206-23-6378-5-1-2** nxjerr:

V E N D I M

1. **HEDHET POSHTË**, si jashtë afatshme kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik **BS2 SH.P.K** e dt. 21.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Ndërtimi i QKMF ne Drenas"** me Nr. të Prok: **206-23-6378-5-1-2** kundër Njoftimit për kontratë të datës 23.06.2023, pasi që e njëjta është parashtruar jashtë afatit ligjor për rishqyrtim në Autoritetin Kontraktues.
2. Ankesa e operatorit ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta është parashtruar jashtë afatit ligjor.
3. Autoriteti Kontraktues, *vazhdon me aktivitetin e prokurimit*.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **BS2 SH.P.K** me date 21.07.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i QKMF ne Drenas"** me Nr. të Prok: **206-23-6378-5-1-2**. Autoriteti Kontraktues, me datë 21.07.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas **BS2 SH.P.K**:

Neni 1 par. 1 dhe 3 i Ligjit Nr.04/L-042 Qëllimi
Neni 6 par 2 i Ligjit Nr. 04/L-042 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 par. 1 dhe 4 i Ligjit Nr. 04/L-042 Barazia në Trajtim/Jo Diskriminim

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Ne BS2 SH.P.K. e bejme kete Kerkese per Rishqyrtim per shkak se A.K. ne Dokumentin Standard te Parakualifikimit te publikuar nga A.K., perkatesisht te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale nenj 8.1&8.2,Kërkesa 5.

Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 5 te DT., ku per te permbushur kete kerkese OE duhet te dorezohet Dëshmia 5. Lista e pajisjeve, Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet qe regjistrohen. Ne rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin, OE duhet te dorëzohet edhe marrëveshjen për shfrytëzim të paisjeve së bashku me dëshmit për paisjet.

Por ne kete rast A.K. ka shkelur LPP-ne pasi qe nuk ka specifikuar se cilat pajisje teknike dhe stabilimente OE i interesuar per pjesëmarrje duhet ti kete, fakt ky qe lene te hapur mundesine per diskriminim te OE dhe jo trajtim te barabarte. A.K. per te trajtuar ne menyre te barabarte sipas LPP-se te gjithë OE te interesuar per pjesëmarrje, duhet qe te precizohet saktësisht se cilat pajisje teknike dhe stabilimente kerkohen per realizimin e ketij projekti.

Ne BS2 SH.P.K. ju njoftojme se nese A.K. nuk merr masa per korrigjimin e ketij leshimi dhe pajisjet teknike nuk detajohen siç duhet, ne do ta dergojme lenden ne Organin Shqyrtues te Prokurimit.

Pergjigjia e Autoriteteit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore

Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik BS2 SH.P.K eshte e jashtë afatshme, duke marre parasysh se eshtge bere me daten 21.07.2023, ndersa hapja e ofertave eshte parapare me daten 24.07.2023.

Edhe pse Kërkesa për ri-shqyrtim eshte e jashtafatshme, pretendimi juaj ankimor eshte i pa bazuar.

Pretendimi juaj per pajisjet dhe stabilimentet e kerkuara, eshe i pa bazuar duke marre parasysh se ne Dokumentin Standard te Parakualifikimit te proceduar për këtë aktivitet, ne faqen e fundit veç se ekziston Aneksi 5. - PAJISJET DHE MEKANIZIMI I OBLIGUESHËM , ku janë specifikuar paisjet e kerkuara si ne vijim:


Nr.	Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia e kërkuar (minimumi)(cope)
1	Eskavator	1
2	Kamion	2
3	Ngarkues	1
4	Cilinder për kompaktësimin e tamponit nën themele	1
6	Paisje për ngjeshjen, vibrimin dhe kompaktësimin e betonit - vibrator	1

Ju këshillojmë qe para se te beni ankesa te tilla, ti lexoni me me vëmendje dokumentet e tenderit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit